



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.953/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetar e kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Franciska Zhitija – Ymeri anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses "Arda Rei" SH.P.K, me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, Zona Industriale, pnr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.P., avokat në Prishtinë, kundër paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Departamenti Ekonomik KE.nr.1654/22 të datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 05.09.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e paditëses "Arda Rei" SH.P.K, me seli në Prishtinë ashtu që **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Departamenti Ekonomik KE.nr.1654/22 i datës 28.04.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti Ekonomik, me aktgjykimin ankimor KE.nr.1654/22 të datës 28.04.2023, ka vendosur më sa vijon:

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "Arda Rei" SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që në emër të materialit ndërtimor të porositur në bazë të kontratës dhe të mbajtur në posedim nga i padituri edhe pas shkëputjes së kontratës t'ia kompensoj paditësit shumën prej 200,710.32 € (dyqind mijë e shtatëqind e dhjetë euro e tridhjetë e dy cent), si dhe të detyrohet i padituri që emër të fitimit të humbur për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të kontratës, t'ia kompensoj paditësit shumën prej 86,780.42 € (tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë euro e njëzet e dy cent), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së kërkesëpadiës e deri në pagesën përfundimtare.

II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të priset aktgjykimi dhe të aprovohet kërkesëpadia ose lëndën ta prish dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja "Arda Rei" SH.P.K, me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 07/06/2017 ka paraqitur padi për kompensim demi, ndërsa e paditura, ne përgjigje ne padi ka kundërshtuar ne tersi pretendimet e palës paditëse, si te pa bazuara.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, ne arsyetim te aktgjykimin te atakuar, gjykata e shkalles se parë, ka arsyetuar se palët ndërgjyqës kanë qenë në marrëdhënie detyrimore, sipas kontratës së datës 20.12.2013, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Arda Rei SH.P.K, me numër prokurimi: MI/13/022/511 dhe numër identifikimi të kontratës 078/2013, me kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, specifikacionet teknike të detyrueshme lidhur me ndërtimin e urës dhe zgjerimin e rrugës nacionale M9-segmenti: Gjurgjicë-Kijev "Sektori D". Me tej, shkalla e parë, ka arsyetuar se nga njoftimi për shkëputjen e kontratës O.E Arda Rei e datës 02.02.2016, me numër të protokollit 443, dhe nga te gjitha komunikimet që gjenden në shkresa të lëndës vërtetohet se paditësi "Arda Rei" është njoftuar lidhur me shkëputjen e kontratës, për shkak se i njëjti nuk ka marr masa për rritjen e ritmit të punimeve edhe përkundër vërejtjeve dhe zgjatjes së afatit për përfundimin e punimeve nga Autoriteti Kontraktues, këtu e paditura. Po ashtu nga aktgjykimi i atakuar rezulton se sipas gjykatës se shkalle se pare, njoftimi për shkëputjen e kontratës është bërë konform dispozitave të nenit 109 dhe 112 të LMD-së, dhe ka ekzistuar baza ligjore për shkëputjen e kontratës, këtë qëndrim gjykata e mbështet në dispozitat e nenit 106 të LMD-së, i cili përcakton se" Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë...". Në rastin konkret nuk është kontestuese se paditësi nuk e ka përmbushë kontratën sipas kushteve kontraktuese dhe nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmbushjen e kontratës përkundër vërejtjeve dhe kërkesave të palës së paditur, andaj janë plotësuar kushtet ligjore për shkëputjen e kontratës

Ne arsyetim te vendimit te atakuar, gjykata e shkalles se parë ka theksuar se i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e paditësit se deri te shkëputja e kontratës ka ardhur si pasojë e mos pagesës së furnitorëve nga ana e të paditurit, sepse paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të provojë se ky detyrim i ka takuar të paditurit, e as faktin se bllokimi i llogarive të tij nga ATK është bërë si pasojë e veprimeve të të paditurit, mirëpo te njëjtat i vlerësoi si te pa bazuara. Po ashtu sipas instancës se parë, janë të pabazuara pretendimet e paditësit lidhur me bazën juridike që i referohet nenit 104 të LMD-së, sepse paditësi në asnjë rrethanë nuk ka pasur rrezik për mos përmbushjen e detyrimit nga i padituri sepse i padituri si Institucion publik nuk rrezikon t'i nënshtrohet jo-solvencës dhe si rrjedhojë të rrezikojë pagesën e çmimit të kontraktuar.

Gjykata, shqyrtoj edhe kërkesën e paditëses lidhur me kompensimin e dëmit, mirëpo ka vlerësuar se duke ju referuar nenit 136 te LMD-së, i cili përcakton se: " Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij", e në rastin konkret, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës ka rezultuar se i padituri e ka njoftuar me kohë paditësin për shkëputjen e kontratës, ndërsa i padituri përkundër faktit se me nenin 19 pika 18.3 ka pasur obligim t'i marrë materialet e tij dhe ta liroj vend punishten, i njëjti nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka pranuar pranimin e materialeve të veta dhe me këtë rreziku për çdo dëm që është paraqitur bie në barrë të vetë paditësit dhe bazuar si me larte gjykata ka vlerësuar se i padituri nuk ka obligim për kompensimin e dëmit, sepse dëmi eventual ka rrjedhë si pasojë e veprimeve respektivisht mosveprimit të vet paditësit edhe pse ne kuptim te nenit 319 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta. Mbi kete baze, ne arsyetim te aktgjykimit te atakuar, gjykata e shkalles se pare, ka konstatuar se në rastin konkret paditësi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të argumentonte bazën për kompensimin e dëmit të pësuar edhe pse sipas dispozitës së sipërcituar i njëjti ka pasur për obligim të vërtetohet edhe të siguroj ekzistimin e dëmit dhe lartësinë e dëmit të shkaktuar si dhe fajësinë e të paditurit për dëmin e pësuar, në mënyrë që të i provojë pretendimet e veta, e jo vetëm t'i referohet paraqitjes së dëmit dhe të kërkoj kompensim pa dhënë asnjë argument të bazuar lidhur me përgjegjësinë e të paditurit, e ku për me tepër, paditësi gjate shqyrtimit gjyqësorë, përkundër faktit se me provat në dispozicion nuk e kishte provuar lidhjen kauzale në mes të veprimit të të paditurit dhe dëmit eventual të shkaktuar, nuk ka propozuar prova të reja, madje ka deklaruar se nuk kërkon plotësim të ekspertizave e as thirrjen e ekspertëve për sqarime shtesë

Gjykata e shkalles se dyte, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e shkalles se dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës se shkalles se dyte, te pathemelta qëndron pretendimi ankimor i të paditëse, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk

mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesve për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara rezulton se paditësi para shkëputjes së kontratës është njoftuar për shkëputjen e saj (njoftimi për shkëputjen e kontratës O.E Arda Rei e datës 02.02.2016, me numër të protokollit 443), dhe nga të gjitha komunikimet që gjenden në shkresa të lëndës vërtetohet se paditësi "Arda Rei" është njoftuar lidhur me shkëputjen e kontratës, për shkak se i njëjti nuk ka marrë masa për rritjen e ritmit të punimeve edhe përkundër vërejtjeve dhe zgjatjes së afatit për përfundimin e punimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, këtu të paditurës. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike edhe sa i përket kërkesës për kompensim demi, pasi që nga provat në shkresa të lëndës rezulton se, i padituri e ka njoftuar me kohë paditësin për shkëputjen e kontratës, ndërsa i padituri përkundër faktit se në kuptim të dispozitave kontraktuese, përkatësisht nenit 19 pika 18.3 ka pasur obligim t'i marrë materialet e tij dhe ta liroj vend punishten, i njëjti nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka pranuar pranimin e materialeve të veta dhe me këtë rreziku për çdo dëm që është paraqitur bie në barrë të vetë paditësit. Me gjithë faktin se me provat në dispozicion nuk e kishte provuar lidhjen kauzale në mes të veprimit të të paditurit dhe dëmit eventual të shkaktuar, pala paditëse rezulton se nuk ka propozuar prova të reja, madje në seancën e datës 13.04.2023 ka deklaruar se nuk kërkon plotësim të ekspertizave e as thirrjen e ekspertëve për sqarime shtesë. Kurse me të drejte, gjykata e shkallës së parë nuk ju fali besimin mendimit dhe konstatimit të eksperteve të ndërtimtarisë dhe financiar, pas që në të dyja ekspertizat mendimi dhe konstatimi i dhënë ka qene në kundërshtim me shkresat e lëndës, imagjinar dhe i pabazuar, derisa pala paditëse nuk ka propozuar marrjen e provave të reja, të besueshme me qellim që të arrihej, që eventualisht të vërtetoheshin pretendimet si në padi

Andaj edhe gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar edhe në kuptim të nenit 106 të LMD-së, i cili përcakton se "Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë...". e në rastin konkret është vërtetuar se paditësi nuk e ka përmbushë kontratën sipas kushteve kontraktuese dhe nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmbushjen e kontratës përkundër vërejtjeve dhe kërkesave të palës së paditur

Po ashtu pala paditëse gjatë shqyrtimit kryesor, me asnjë provë materiale nuk ka arritur ti vërteton pretendimet e saja. Sipas nenit 319.1 të LPK-së është paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*, ndërsa neni 322.2 ka paraparë: *Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër*.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se në rastin konkret është zbatuar drejt e drejta materiale, për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensimi e demit. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.953/2023, me datën 05/09/2023

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami